

# KONKURS

për  
ESE HULUMTUEESE  
për **maturantët e vitit 2025**

Ekonomi  
Drejtësi  
Kriminalistikë  
IT  
Shkenca Poltike

Afatet e aplikimit  
Nga 5 qershor deri më 1 korrik

**CONTACT**



[www.iust.edu.mk](http://www.iust.edu.mk)



[admission@iust.edu.mk](mailto:admission@iust.edu.mk)



International University of Struga

## **THIRRJE PËR PJESËMARRJE NË KONKURSIN E ESEVE HULUMTUESE – PËR MATURANTËT E VITIT 2025**

Universiteti Ndërkombëtar në Strugë shpall konkurs kombëtar për ese për të gjithë maturantët e vitit 2025 nga e gjithë rajoni, me qëllim të promovimit të mendimit kritik, hulumtimit dhe kreativitetit tek të rinjtë. Ky konkurs është një mundësi e shkëlqyer për të shprehur njohuritë dhe pasionin në fusha me rëndësi për të ardhmen tuaj akademike dhe profesionale.

### **Fushat dhe Temat e Konkursit**

Pjesëmarrësit mund të zgjedhin njërën nga temat e mëposhtme, të cilat janë të përzgjedhura sipas nivelit të gjimnazit dhe orientimeve më të kërkuara sot:

#### **Ekonomi:**

Roli i inovacionit dhe teknologjisë në zhvillimin ekonomik të një shteti  
Si ndikon edukimi financiar tek të rinjtë?

#### **Juridik:**

Pse është e rëndësishme drejtësia për një shoqëri demokratike?  
Të drejtat themelore të njeriut – nga teoria në praktikë

#### **Kriminalistikë:**

Roli i teknologjisë në zbulimin e krimeve  
Pse është i rëndësishëm vendi i krimit për hetimin?

#### **Teknologji e Informacionit (IT):**

Si po ndryshon inteligjenca artificiale mënyrën tonë të të jetuarit?  
Siguria në internet: sfidë për të rinjtë në epokën digjitale

#### **Shkenca Politike:**

Demokracia dhe të rinjtë: a po marrin pjesë mjaftueshëm në vendimmarrje?  
Pjesëmarrja qytetare në epokën e rrjeteve sociale

## **Kushtet për Aplikim**

Të drejtë pjesëmarrjeje kanë të gjithë maturantët e vitit 2025 me notë mesatare mbi 3.5 gjatë shkollimit të mesëm.

*Avantazh do të kenë kandidatët që:*

*Kanë marrë pjesë në aktivitete shkollore dhe jashtëshkollore (të dëshmuara me çertifikata).*

*Njohin gjuhën angleze në nivel komunikues ose më të lartë (të dëshmuar me dokumentacion përkatës).*

## **Aspektet Teknike të Eseve**

Eseja duhet të jetë maksimalisht 5 faqe A4, me këto specifika:

- *Font: Times New Roman, madhësia 12, ndërreshtim 1.5*
- *Margjinat: 2.5 cm në të gjitha anët*
- *Eseja nuk duhet të përmbajë plagjiaturë; të gjitha burimet duhet të citohen në fund në mënyrë të thjeshtë.*
- *Gjuhë e qartë, e rrjedhshme dhe e strukturuar me hyrje, trajtim të temës dhe përfundim.*

Eseja duhet të përmbajë:

- *Emrin dhe mbiemrin e autorit*
- *Emrin e shkollës së mesme dhe drejtimin*
- *Qytetin dhe vendin*
- *Numrin e kontaktit dhe adresën e emailit*
- *Temën e përzgjedhur*

## **Afatet dhe Aplikimi**

Aplikimet hapen më 5 qershor 2025

Afati i fundit për dërgimin e esesë është 1 korrik 2025

Eseja dorëzohet ekskluzivisht në emailin zyrtar:  
admission@eust.edu.mk

## **Ceremonia për Prezantimin e Eseve dhe Ndarjen e Çmimeve**

Ceremonia do të organizohet në kampusin e Universitetit Ndërkombëtar në Strugë, më datë 4 korrik 2025.

*Shpenzimet e udhëtimit mbulohen nga universiteti.*

### **Shpërblimet**

1. Vendi i Parë – Mobilitet studimi në Universitetin “Juan Carlos”, Madrid – Spanjë (3–6 muaj)
2. Vendi i Dytë – Mobilitet studimi në Bruksel, Belgjikë (3–6 muaj)
3. Vendi i Tretë – Mobilitet studimi në Itali (3–6 muaj)
4. Vendi i Katërt – Mobilitet studimi në Stamboll, Turqi (3–6 muaj)

**Të gjithë pjesëmarrësit do të pajisen me certifikatë pjesëmarrjeje dhe 20% bursë për studime në Universitetin Ndërkombëtar në Strugë.**

*Për çdo pyetje, na shkruani në: [admission@eust.edu.mk](mailto:admission@eust.edu.mk)*